



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 310/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Laziq dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Rahovec, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Rahovec, për shkak të vendosjes së posterit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

HIDHET si e pasafatshme ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 09.06.2014, ora 18:55 nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Rahovec në të cilën theksohet se me datën 06.06.2014, rreth orës 15:00, aktivistët e LVV-së kanë vërejtur se mbi rrugën publike “Avdullah Bugari” (afër ndërtesës së KEK-ut) në Rahovec, ishte i vendosur posteri i kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Enver Hoxhaj nga subjekti politik PDK. Parashtruesi i ankesës pretendon, se me këtë rast është shkelur neni 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmerinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

PZAP-i, konstaton se ankesa në fjalë është e pasafatshme pasi që neni 3.4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, parasheh që për të gjitha çështje që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin ankesa duhet të dorëzohet në PZAP brenda 72 orëve nga shkelja e supozuar, ndërsa ngjarja për të cilin pretendon pala ankuese se posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik PDK ka qenë i vendosur mbi rrugë publike, dhe se kanë vërejtur me datën 06.06.2014 në ora 15:00, ndërsa ankesa në PZAP është dorëzuar me datën 09.06.2014 në ora 18:55 çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë prej 72 orë për dorëzimin e ankesës në PZAP. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 3.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe nenit 118.1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 310/2014 më datën 11.06.2014



Kshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.